

Matja e shërbimeve të e-pushtetit në Maqedoni¹

(rezultatet nga matja e katërt)

Marjan Gushev, Dejan Spasov, Goce Armenski

Universiteti “Sh. Kirili dhe Metodij”, Shkup

Hyrje

Kjo është matja e katërt e onlajn-sofistikimit në nivel qeveritar në Maqedoni. Matja është bërë në periudhën mars/prill 2008 dhe kjo pasqyron gjendjen e projekteve të realizuara në vitin 2008. Kësaj radhe kemi punuar sipas sistemit të ri të vlerësimit të Kepxheminit prej pesë niveleve, të cilin i pestë u shtua me qëllim që të përfshihet ideja për dhënie proaktive dhe të automatizuar të shërbimeve. Në këtë dokument do ta krahasojmë zhvillimin e shërbimeve të e-qeverisë në Maqedoni me sistemin e vjetër prej 4 niveleve dhe do ta krahasojmë gjendjen në Maqedoni me vendet e tjera të BE duke përdorur sistemin për vlerësim prej 5 niveleve.

1. Metodologjia

Në tabelën nr.1 janë dhënë njëzet shërbimet publike të cilat është ndjekur niveli i onlajn-sofistikimit. Në vendet anëtare të BE këto shërbime u definuan nga ana e Komisionit Evropian dhe u ndoqën nga ana e Kepxheminit.

| Qytetarë | | Biznese | |
|----------|---------------------------------|---------|---|
| 1 | Tatimi i të ardhurave | 1 | Kontribute sociale për të punësuarit |
| 2 | Kërkim pune | 2 | Të dhëna ekonomike |
| 3 | Kontribute për sigurim social | 3 | TVSH |
| 4 | Dokumente personale | 4 | Regjistrim i ndërmarrjes së re |
| 5 | Regjistrimi i automjetit | 5 | Dorëzimi i të dhënave në Entin për statistikë |
| 6 | Leje për ndërtim | 6 | Paraqitje doganore |
| 7 | Paraqitje në polici | 7 | Leje ekologjike |
| 8 | Biblioteka publike | 8 | Furnizime publike |
| 9 | Certifikatat | | |
| 10 | Regjistrimi në arsim të lartë | | |
| 11 | Lajmërim për shpërngulje | | |
| 12 | Shërbime lidhur me shëndetësinë | | |

Tabela nr. 1 : 20 shërbimet themelore

¹ Ky hulumtim u realizua në kuadër të projektit të financuar nga BE – Programi i gjashtë i kornizës 045472 – We-Go (Rritja e ekspertizës për e-pushtet në Ballkanin Perëndimor)

Shërbimi Kontribute për sigurim social përbëhet prej këtyre nënshërbimeve elementare: kontribute për të papunësuarit, të dhëna shtesë për fëmijë, harxhime mjekësore dhe bursa për studentë. Në shërbimin Dokumente personale bëjnë pjesë letra e njoftimit, pasaporta dhe leja e vozitjes. Shërbimet themelore në “Certifikatat” janë certifikatat e lindjes, kurorëzimit dhe të vdekurve.

Secili shërbim elementar apo nën-shërbim mund të bëjë pjesë në njërin prej gjashtë niveleve të sofistikimit:

Niveli 0 – Nuk ka informata

Niveli 1 – Informata

Niveli 2 – Interaksion i njëanshëm

Niveli 3 – Interaksion i dyanshëm

Niveli 4 – Transaksioni

Niveli 5 – Personalizim


Këtë vit, shërbimet si tatimi i të ardhurave, kontributet për sigurim social, dokumentacioni personal, bibliotekat publike, dhënia e të dhënave në entin për Statistikë dhe lejet ekologjike vlerësohen sipas sistemit të vlerësimit të përbërë prej pesë niveleve, ndërsa pjesa tjetër e shërbimeve vlerësohet në pajtim me sistemin për vlerësim në katër nivele.

Onlajn-sofistikimi i shërbimeve elementare llogaritet në përqindje (%) si raport në mes nivelit të shërbimit dhe vlerës maksimale që mund ta ketë. Onlajn-sofistikimi i një shërbimi elementar siç janë kontributet për sigurim social është mesatarja nga katër shërbimet elementare – kontributet për të papunësuarit, shtesat për fëmijë, shpenzimet mjekësore dhe bursat studentore. Niveli përfundimtar i onlajn-sofistikimit është mesatarja e sofistikimit të 20 shërbimeve themelore.

Më në fund do të përmendim dy grupe të caktuar: qytetarët ose bizneset. Përveç kësaj, janë katër klasterë (grupime) sipas të cilave ndahen më tej 20 shërbimet themelore: klasteri për të ardhura, regjistrime dhe paraqitja e tatimeve dhe klasteri për leje. Do ta paraqesim zhvillimin për secilin grup të caktuar dhe secilin klaster.

2. Rezultate

Në fotografinë nr. 1 janë dhënë të gjithë 20 shërbimet publike së bashku me vlerësimin për onlajn-sofistikimin e tyre, sipas shkallës për vlerësim në katër nivele. Fotografia nr. 2. e paraqet përparimin e shërbimeve themelore prej vitit 2004 deri në vitin 2008 sipas shkallës për vlerësim në katër nivele.




Fotografia nr.1: Zhvillimi i onlajn-sofistikimit i 20 shërbimeve themelore në Maqedoni në periudhën prej vitit 2004 deri në vitin 2008.


Onlajn-sofistikimi (OS) i Republikës së Maqedonisë llogaritet si mesatarja e 20 shërbimeve themelore. Sipas nivelit të matjes së parë në vitin 2004 ajo ishte 9%, në mars të vitit 2006 OS Maqedonia e kishte 32,75%, ndërsa në mars 2007, OS ishte 50%. Në fotografinë nr. 2 është paraqitur zhvillimi i onlajn-shërbimeve në Maqedoni prej vitit 2004 deri në vitin 2008, duke përdorur sistemin e vjetër për vlerësim me katër nivele.

Ndryshimet prej vitit të kaluar janë: furnizimet publike arritën nivel të sofistikimit prej 100%, ekziston sistem i ri interneti për aplikacione për kredit dhe bursa studentore, kurse universitetet dhe spitalet u bënë pak më aktive në internet.

Në fotografinë nr. 3 krahasohet niveli aktual i sofistikimit për vitin 2008 i cili është 48.5% me metodologjinë e re të vendeve anëtare të BE. Me qëllim që në mënyrë të rregullt të krahasohet niveli i sofistikimit të Maqedonisë dhe BE për vitin 2007, për Maqedoninë e zbatuam sistemin e ri për vlerësim prej pesë niveleve. Mund të shfrytëzojmë përsëri përfundimin nga raporti i vitit të kaluar: Maqedonia për momentin ndodhet në pozitën në të cilin ishin vendet e BE-së në vitin 2001/2002. Ndryshimi i vetëm është se këtë vit niveli i sofistikimit i Maqedonisë është nën minimumin e 28 vendeve anëtare të BE-së, kështu që dallimi mes Maqedonisë dhe BE-së është rritur. Në fotografinë nr. 4 duket se ka një zhvillim (progres) në raport me të gjitha onlajn-shërbimet, mirëpo Maqedonia është akoma larg nga niveli i dëshiruar i sofistikimit prej 30%, ku parashohim se interoperabiliteti do të bëhet një çështje e rëndësishme në lëminë e e-pushtetit. Në qershor të vitit 2008 do të futen dy shërbime të reja nga niveli i katërt: paraqitjet doganore dhe kontributet sociale, ashtu që përqindja e shërbimeve tërësisht të disponueshme në internet do të jetë 25%.




Fotografia 2: Rritje e onlajn-sofistikimit në Maqedoni prej 2004 – 2008 sipas metodologjisë më të vjetër të vlerësimit me katër nivele




Fotografia 3: Krahasimi i onlajn-sofistikimit në Maqedoni prej 2007deri në vitin 2008 dhe në vendet anëtare të BE-së prej 2001 deri në vitin 2007.


Shërbimet në kolonën e majtë të tabelës nr. 1 janë të ashtuquajtura shërbime për qytetarët, pasi që ata janë tregues të nivelit të sofistikimit të shërbimeve të qeverisë për qytetarët. Në këtë kategori ka 12 shërbime që kanë të bëjnë me mënyrat më të shpeshta të interaksionit mes qytetarëve dhe Qeverisë. Tetë (8) shërbimet tjera e matin interaksionin ndërmjet Qeverisë dhe bizneseve. Fotografia nr. 5 e paraqet rritjen e onlajn-sofistikimit të shërbimeve për qytetarët në Maqedoni. Në fotografinë nr. 6 bëhet krahasimi i nivelit të sofistikimit të shërbimeve për qytetarët e Maqedonisë në vitin 2008 me nivelin e sofistikimit të vendeve anëtare të BE-së. Fotografitë 7 dhe 8 janë për sektorin e biznesit.




Fotografia 4: Përqindja e shërbimeve tërësisht të disponueshme nëpërmjet internetit




Fotografia 5: Rritja e onlajn-softistikimit të shërbimeve për qytetarët në Maqedoni në periudhën 2004 – 2008 sipas metodologjisë më të vjetër të vlerësimit me katër nivele



Fotografia 6: Krahasimi i shërbimeve për qytetarët ndërmjet Maqedonisë në periudhën 2007/2008 dhe vendeve anëtare të BE-së në periudhën 2001/2007



Fotografia 7: Rritja e onlajn-sofistikimit të shërbimeve për bizneset në Maqedoni në periudhën 2004-2008 sipas metodologjisë më të vjetër për vlerësim me katër nivele



Fotografia 8: Krahasimi i shërbimeve për bizneset ndërmjet Maqedonisë në periudhën 2007/2008 dhe vendeve anëtare të BE-së në periudhën 2001/2007

Njëzet shërbimet që janë të shënuara në tabelën nr. 1 janë ndarë në katër klasterë:

1. *Klasteri për gjenerim të të ardhurave* – mjetet financiare lëvizin prej qytetarëve kah Qeveria
2. *Klasteri për paraqitje të tatimeve* – mjetet financiare lëvizin në drejtim të kundërt
3. *Klasteri për regjistrim dhe*
4. *Klasteri për leje*

Gjendja e klasterit për gjenerim të të ardhurave është dhënë në fotografitë 7,8 dhe 9. Në qershor të vitit 2008 paraqitjet doganore dhe kontributet sociale do të arrijnë nivelin e sofistikimit prej 100%, ashtu që vetë klasteri do të arrijë nivel të sofistikimit prej 90%. Me këtë, ky klaster do të jetë shumë afër nivelit të BE.


Klasteri për regjistrim i përfshinë shërbimet për ruajtje të detyrueshme të informatave. Fotografitë 10, 11 dhe 12 e paraqesin gjendjen e klasterit për regjistrime dhe e krahasojnë

me klasterin për regjistrim të vendeve anëtare të BE-aë. Vitin e kaluar nuk kishte ndryshime në këtë klaster.


Klasteri për paraqitje të tatimeve i përfshinë shërbimet që u jepen qytetarëve dhe bizneseve për në lidhje me tatimet dhe kontributet. Fotografitë 13, 14 dhe 15 e paraqesin këtë klaster. Ky klaster është më pak i zhvilluar prej të tjerëve. Furnizimet publike kanë arritur nivelin maksimal të sofistikimit prej 100%, kurse spitalet filluan të publikojnë informata në internet. Këtë vit nuk mundëm të gjejmë informata për shërbimin “paraqitje në polici”. Burimi i vetëm i informatave për këtë shërbim ishte ueb-faqja e Ministrisë së punëve të brendshme, e cila tani ka dizajn të ri dhe më nuk jep informata për këtë shërbim.

Klasteri për leje i përfshinë dokumentet që i jep Qeveria. Ky klaster është paraqitur në fotografitë 16, 17 dhe 18. Universitetet shtetërore në këtë klaster sivjet janë më aktive në krahasim me vitin e kaluar, kështu që niveli i sofistikimit është rritur. Mirëpo, sofistikimi i përgjithshëm i këtij klasteri ka rënë për shkak të sistemit të ri të vlerësimit prej pesë niveleve.


Në fotografitë që vijojnë janë paraqitur rezultatet e klasterëve:




Fotografia 7: Klasteri për gjenerimin e të ardhurave




Fotografia 8: Si ka ecur zhvillimi i klasterit për gjenerim të të ardhurave në Maqedoni në periudhën 2004 – 2008 sipas metodologjisë më të vjetër të vlerësimit me katër nivele




Fotografia 9: Krahasimi i klasterëve për gjenerim të të ardhurave në Maqedoni prej 2007/2008 dhe vendeve anëtare të BE-së prej 2001/2007




Fotografia 10: Klasteri për regjistrime




Fotografia 11: Zhvillimi i klasterit për regjistrime në Maqedoni në periudhën 2004 – 2008 sipas metodologjisë më të vjetër të vlerësimit me katër nivele




Fotografia 12: Krahasimi i klasterëve për regjistrime në Maqedoni prej 2007/2008 dhe vendeve anëtare të BE-së prej 2001/2007




Fotografia 13: Klasteri për paraqitje të tatimeve




Fotografia 14: Zhvillimi i klasterit për paraqitje të tatimeve në Maqedoni në periudhën 2004 – 2008 sipas metodologjisë më të vjetër të vlerësimit me katër nivele




Fotografia 15: Krahasimi i klasterëve për paraqitje të tatimeve në Maqedoni prej 2007/2008 dhe vendeve anëtare të BE-së prej 2001/



Fotografia 16: Klasteri për leje



Fotografia 17: Zhvillimi i klasterit për leje në Maqedoni në periudhën 2004 – 2008 sipas metodologjisë më të vjetër të vlerësimit me katër nivele



Fotografia 18: Krahasimi i klasterëve për leje në Maqedoni prej 2007/2008 dhe vendeve anëtare të BE-së prej 2001/2007

Vlerësimi i portalit nacional

Kepxhemini ka përgatitur tregues (indikatorë) të ri me qëllim që të sigurojë evaluim më të mirë të shërbimeve të reja të drejtuara kah shfrytëzuesit. Vlerësimi i portalit nacional është njëri prej katër treguesve drejtuar kah shfrytëzuesi, të cilin e kemi përdorur në studimin tonë. Portalin nacional të Maqedonisë mund ta gjeni në www.uslugi.gov.mk.

Pyetja më e rëndësishme në vlerësimin e portalit nacional është se sa prej njëzet shërbimeve janë të integruara në portalin nacional? Në Maqedoni, 25% e shërbimeve janë të disponueshme në portalin nacional. Këtu mund t'i gjeni këto shërbime: kontributet për sigurim social, dokumente personale, regjistrimi i automjetit, certifikatat dhe lajmërimet për shpërngulje. Portali nacional karakterizohet me 2 regjime të prezantimit dhe me grafikë konzistente, kështu që sipas metodologjisë së Kepxheminit (faqe 116) portali nacional ka nivel të sofistikimit prej 66,6%.

Përfundimi

Në vitin 2007 Qeveria e Maqedonisë realizoi një numër të madh të projekteve infrastrukturale, me qëllim që IT pajisjet të jenë më të qasshme për popullatën (sigurimi i IT pajisjeve nëpër shkolla, donacione të vauçerëve për kompjuterë për absolventët) dhe me qëllim që të mundësojë një mjedis biznesi më të mirë dhe mjedis ligjor (ligji për tregti elektronike, tatime të zvogëluara për IT prej 18 në 5përqind) Nuk kishte projekte nga lëmia e e-pushtetit të cilat do të ndikonin në matjen për shërbimet e e-qeverisë. Qeveria beson se këto projekte infrastrukturale do të krijojnë kushte për përmirësim në vitet e ardhshme.

Trendi gjithnjë e më i përhapur i matjes së shërbimeve nga lëmia e e-pushtetit në realitet u ngadalësua. Maqedonia nuk arriti ta mbajë zhvillimin e onlajn-sofistikimit prej 16% në vjet, që u arrit në vitin 2006. Kjo nuk është vetëm për shkak të metodologjisë së ndryshuar, por edhe për shkak të faktit se nuk kishte rritje të nivelit të sofistikimit të shërbimeve që u matën. Rritja e matur duhet të jetë 13% që të mund në të ardhmen e afërt të arrihet niveli i sofistikimit i vendeve anëtare të BE-së. Dallimi më i madh që paraqitet me këtë matje është te sektori për sigurimin e shërbimeve për qytetarët.

Literatura e shfrytëzuar

[1] Gushev, Armenski (prill 2006): Analiza e dallimeve në e-pushtetin tek vendet e Ballkanit perëndimor, www.metamorphosis.org.mk, 12.5.2006

[2] Kepxhemini. (qershor 2006). [Disponueshmëria e shërbimeve publike në internet: Si përparon Evropa?](#) Internet-hulumtimi për raportin për shërbimet publike elektronike nga matja e 6-të në qershor 2006. Kepxhemini.

[3] Kepxhemini (matja e 7-të, shtator 2007) Sigurimi i shërbimeve publike nëpërmjet internetit.

[4] Gushev, Spasov, Armenski “Zhvillimi i shërbimeve nga lëmia e e-pushtetit në Maqedoni (onlajn-sofistikimi i shërbimeve qeveritare)” Informatika, 31 (2007) 397-406

[5] Pakti për stabilitet të Evropës Juglindore, Grupi punues eEJL (www.stabilitypact.org/e-see).

[6] Kepxhemini, Studime për disponueshmërinë e shërbimeve publike në internet në vitin 2005 në lëminë e e-pushtetit në Kroaci;

http://www.e-croatia.hr/repozitorij/dokumenti/downloads/Online_Availability_2005.pdf

Shtojca A: 20 shërbimet themelore publike

Vijon sqarimi për secilin prej 20 shërbimeve themelore publike dhe sqarimi për mënyrën se si e formojmë vlerësimin për Republikën e Maqedonisë.

1. Tatimi i të ardhurave ↓

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 5 |
| 2007 | 2 | 4 |

Dhënës i këtij shërbimi është Drejtoria për të ardhura publike. Procedura për paraqitjen e tatimit mund të fillohet duke shkarkuar formularin nga ueb-faqja e tyre: www.ujp.gov.mk.

Niveli i sofistikimit i këtij parametri mbetet i njëjtë – 2. megjithatë, pasi që sistemi për vlerësim të këtij parametri bazohet në modelin me pesë nivele, onlajn-sofistikimi u zvogëluar prej 50 në 40 përqind (%).

2. Kërkimi i punës →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 3 | 4 |
| 2007 | 3 | 4 |

Onlajn-sofistikimi i këtij shërbimi mbetet në nivel të njëjtë prej 75%.

Sipas metodologjisë së Kepxheminit, ky shërbim mund të marrë vlerën maksimale 4, nëse dhënësi i shërbimit siguron mundësi për informim elektronik për vendet e punës paraprakisht të zgjedhura lidhur me profilin e dhënë të personit që kërkon punë.

Agjensioni për punësim i Republikës së Maqedonisë ofron mundësi për kërkim onlajn të bazës së të dhënave me vende të lira pune. Mirëpo, nuk mundëm ti gjejmë adresat e internetit të 30 qendrave regjionale për punësim.

Ueb-adresa e dhënësit të këtij shërbimi është: <http://www.zvrm.gov.mk>

3. Kontributet për sigurim social ↑

Në këtë kategori ka katër shërbime që janë definuar nga Komisioni evropian.

a) Kontribute për të papunësuarit

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 1 | 5 |
| 2007 | 1 | 4 |

b) Shtesat e fëmijëve

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 5 |
| 2007 | 2 | 4 |

c) Shpenzimet mjekësore

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 1 | 5 |
| 2007 | 1 | 4 |

d) Bursat studentore

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 3 | 5 |
| 2007 | 1 | 4 |

Dhënës të ndryshëm të shërbimeve janë përfshirë në sigurimin e kontributeve për sigurim social. Ministria për punë dhe politikë sociale është përgjegjëse për ndihmë sociale dhe për shtesat e fëmijëve. Informatat për shërbimet mund t'i gjeni në:

Për të papunësuarit: www.mtsp.gov.mk

Për shpenzimet mjekësore: www.fzo.org.mk

Për bursat studentore: www.raspredelba.gov.mk

Sipas llojit të ri të vlerësimit prej 5 niveleve, ky sistem ka sofistikimin prej 35%.

4. Dokumente personale ↓

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 5 |
| 2007 | 2 | 3 |

Në Maqedoni, dokumente personale janë pasaporta, letra e njoftimit dhe leja e vozitjes. Dhënës i këtij shërbimi është Ministria e punëve të brendshme. Qytetarët mund të marrin informata dhe formularë në www.uslugi.gov.mk. Niveli maksimal i sivjetmë është 5, kështu që onlajn-sofistikimi ra në 40%.

5. Regjistrimi i automjeteve →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 4 |
| 2007 | 2 | 4 |

I njëjti dhënës i shërbimeve nga pika 4. Onlajn-sofistikimi mbetet 50%.

6. Miratimi i lejes për ndërtim →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 1 | 4 |
| 2007 | 1 | 4 |

Onlajn-sofistikimi i këtij shërbimi mbetet në nivel të njëjtë prej 25%. Informatat në lidhje me atë se si të fillohet procedura për marrjen e lejes për ndërtim mund ti gjeni në <http://www.e-skopje.gov.mk/>. Informata për marrjen e dëshmisë për posedim të pronës mund të gjenden në www.katastar.gov.mk.

7. Paraqitja në polici ↓

| Viti | Niveli i | Niveli |
|------|----------|--------|
|------|----------|--------|

| | sofistikimit | maksimal |
|------|--------------|----------|
| 2008 | 0 | 3 |
| 2007 | 0 | 3 |

Ueb-faqja e Ministrisë së punëve të brendshme ka tërësisht një dizajn të ri dhe nuk ka në disponim informata për paraqitje në polici. Niveli aktual i sofistikimit është 0%.

8. Bibliotekat publike ↓

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 3 | 5 |
| 2007 | 3 | 4 |

Maqedonia si pjesë e sistemit onlajn-bibliografik për bashkëpunim COBINS.Net ka ueb-faqe të qasshme për opinionin me mundësi për onlajn-kërkim. Sipas metodologjisë së re, niveli i onlajn-sofistikimit është 60%.

Ueb-adresa e dhënësit të këtij shërbimi është: <http://vbmk.nubsk.edu.mk/cobiss/>

9. Certifikatat →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 4 |
| 2007 | 2 | 3 |

I njëjti dhënës i shërbimeve nga pika 4. Onlajn-sofistikimi është 50%, pasi që këtë vit kemi ndjekur rekomandimet e Kepxheminit për nivelin maksimal.

10. Regjistrimi në arsim të lartë ↑

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 1 | 4 |

| | | |
|------|---|---|
| 2007 | 0 | 4 |
|------|---|---|

Këtë vit vërejtëm një trend pozitiv në publikimin e informatave në internet të parapara për studentët e ardhshëm, ashtu që këtë vit vendosëm që ta vendosim këtë shërbim në nivelin e parë të onlajn-sofistikimit e cila në përqindje është 25%.

11. Lajmërimi për shpërngulje →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 4 |
| 2007 | 2 | 3 |

Onlajn-sofistikimi është 50%. Dhënësi i këtij shërbimi është po ai i nga pika 4, me të njëjtin nivel të sofistikimit si në vitin 2007.

12. Shërbime lidhur me shëndetësinë ↑

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 1 | 4 |
| 2007 | 0 | 4 |

Këtë vit arritëm të gjejmë disa ueb-faqe të spitaleve të cilat ofrojnë informata nga niveli i parë, kështu që niveli i sofistikimit tani është 25%.

13. Kontribute sociale →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 3 | 4 |
| 2007 | 3 | 4 |

Onlajn-sofistikimi është 75%. Dhënës i këtij shërbimi është Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë. Dhënësi ka ueb-servisin me mundësi që plotësisht në mënyrë elektronike të përpunojë paraqitjet për kontribute sociale të të punësuarve.

Ueb-adresa është: <http://www.piom.com.mk/>

14. Të dhënat ekonomike →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 4 | 4 |
| 2007 | 4 | 4 |

Onlajn-sofistikimi i këtij shërbimi është 100%. Pagesa e tatimeve pa letër ishte pjesë e iniciativës së USAID-it për e-Qeveri. Dhënës i këtij shërbimi është Drejtoria për të ardhura publike. Sistemin e keni në disponim në <http://etax.ujp.gov.mk/>

15. TVSH →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 4 | 4 |
| 2007 | 4 | 4 |

I njëjti dhënës i shërbimeve nga pika 14. Niveli i sofistikimit ngelën 100%

16. Regjistrimi i ndërmarrjes (firmës) së re →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 4 |
| 2007 | 2 | 4 |

Onlajn-sofistikimi është 50%. Dhënës i këtij shërbimi është Regjistri qendror. Në ueb-faqen e tyre mund të shkarkoni formularët për regjistrimin e një ndërmarrjeje të re. Ueb-adresa është: www.crm.org.mk/

17. Paraqitja e të dhënave në Entin për statistikë →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 0 | 5 |
| 2007 | 0 | 3 |

Niveli i sofistikimit të këtij shërbimi mbetet 0%.

18. Paraqitjet doganore →

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 2 | 4 |
| 2007 | 2 | 4 |

Onlajn-sofistikimi mbetet në nivel të njëjtë 50%. Drejtoria e doganave ka ueb-faqe të qasshme për publikun me mundësi për të shkarkuar formularë: www.customs.gov.mk

19. Lejet ekologjike ↓

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 1 | 5 |
| 2007 | 1 | 4 |

Niveli i onlajn-sofistikimit për këtë shërbim është 1, por për shkak të sistemit të vlerësimit me pesë nivele – sofistikimi u zvogëlua në 20%. Njësitë e vetëqeverisjes lokale, si p.sh. Komuna e Velesit, në ueb-faqen e saj (www.veles.gov.mk) ka informata në lidhje me atë si të fillohet procedura për marrjen e Lejeve të integruara ekologjike.

20. Furnizime publike ↑

| Viti | Niveli i sofistikimit | Niveli maksimal |
|------|-----------------------|-----------------|
| 2008 | 3 | 4 |
| 2007 | 4 | 4 |

Me projektin e USAID-it për e-Qeveri në bashkëpunim me Byronë për furnizime publike u përgatit një sistem për e-furnizime për të kryer furnizimet publike nëpërmjet internetit. Sistemin mund ta gjeni në <https://e-nabavki.gov.mk> dhe këtë vit e shfrytëzojnë edhe Qeveria edhe pushteti lokal. Onlajn-sofistikimi u rrit në 100%.